



Partia
Demokratike

Nr. 310 Prot.

Tiranë, 22/07/2026

Lënda: KËRKESË PËR HETIM TË POSAÇËM MBI NDIKIMIN E PROJEKTIT "SMART CITY" NË TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE TË NJERIUT

Nga: **Z. Franci NURI**, Sekretar për të Drejtat e Njeriut në Partinë Demokratike;
me adresë komunikimi: Partia Demokratike e Shqipërisë, Bulevardi "Zhan d'Ark", nr. 11, Tiranë dhe E-mail: pd@rithemelimi.com

Baza ligjore: Ligji Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar; Ligji Nr.8580, datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike", i ndryshuar.

Drejtuar: AVOKATIT TË POPULLIT

I nderuar z. Avokat i Popullit,

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës dhe ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, si dhe dispozitave të Ligjit Nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike", i ndryshuar, duke marrë në konsideratë ndikimin e projektit "SMART CITY" mbi jetën private, të dhënat personale dhe të drejtat e liritë themelore të qytetarëve, kërkojmë vënien në dispozicion të informacionit dhe dokumentacionit, si vijon:

I – Nisjen e një hetimi të posaçëm mbi ndikimin e projektit "Smart City" në:

- a) Të drejtën për jetën private.
- b) Mbrojtjen e të dhënave personale.
- c) Lirinë e shprehjes.
- d) Lirinë e tubimit paqësor.
- e) Lirinë e organizimit dhe veprimtarisë politike.
- f) Lirinë e medias.
- g) Të drejtën për të mos iu nënshtruar profilizimit arbitrar.
- h) Prezumimin e pafajësisë.
- i) Të drejtat e fëmijëve.
- j) Parimin e mosdiskriminimit.
- k) Të drejtën për mjet juridik efektiv.

- l) Parimin e ligjshmërisë, domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit.

II – Kërkojmë veçanërisht të verifikohet nga Institucioni i Avokatit të Popullit:

- a) Nëse sistemi përbën mbikëqyrje të përgjithshme dhe të padiferencuar.
- b) Nëse prodhon efekt frikësues ndaj protestuesve, aktivistëve, gazetarëve dhe opozitarëve.
- c) Nëse ligji përcakton qartë kategoritë e personave që mund të monitorohen.
- d) Nëse ekzistojnë garanci kundër keqpërdorimit politik.
- e) Nëse qytetarët kanë të drejtë reale ankimi.
- f) Nëse përfshirja e fëmijëve është proporcionalisht e justifikuar.

III – kërkojmë nga Avokati i Popullit:

- a) inspektimin e Qendrës së Komandës;
- b) marrjen e kontratës dhe dokumentacionit teknik;
- c) dëgjimin e institucioneve përgjegjëse;
- d) konsultimin me ekspertë të pavarur;
- e) publikimin e një raporti të posaçëm;
- f) rekomandimin e pezullimit të funksioneve biometrike dhe profilizuese;
- g) rekomandimin e miratimit të një kuadri të posaçëm ligjor.

Duke marrë në konsideratë interesin e lartë publik, përpunimin e të dhënave në shkallë kombëtare dhe përfshirjen e fëmijëve, kërkojmë trajtimin me përparësi të kësaj kërkesë.

Kërkojmë gjithashtu ruajtjen e plotë të dokumentacionit, komunikimeve elektronike, procesverbaleve, log-eve të sistemit, raporteve teknike dhe regjistrave të aksesit që lidhen me projektin “Smart City”, me qëllim parandalimin e humbjes, ndryshimit ose fshirjes së tyre.

Duke ju falenderuar,

SEKRETARI PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË PARTINË DEMOKRATIKE

Franci NURI

Z. Franci NURI